

VENDIM
Nr. 543, datë 9.10.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“SISTEMIM DHE NDRIÇIM, RRUGA E MALIT, RRUGA “KALAJA””, NË BASHKINË E
KRUIJËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim dhe ndriçim, Rruga e Malit, rruga “Kalaja””, në Bashkinë e Krujës.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Krujës.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë “truall”, me sipërfaqe 61.7 (gjashtëdhjetë e një pikë shtatë) m², me vlerë të përgjithshme prej 247 479 (dyqind e dyzet e shtatë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 247 479 (dyqind e dyzet e shtatë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Krujës, planifikuar në buxhetin e saj.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Krujës.
 6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë e Krujës të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.
 8. Regjistrimi i ri i pasurisë 61.7 (gjashtëdhjetë e një pikë shtatë) m², “truall”, për projektin “Sistemim dhe ndriçim, Rruga e Malit, rruga “Kalaja””, të bëhet në favor të Bashkisë Krujë.
 9. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krujë dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E TË CILËVE DO TË SHPRONËSOHEN PËR OBJEKTIN:
 “SISTEMIM DHE NDRIÇIM RRUGA E MALIT, RRUGA KALAJA”

Nr.	Emër, mbiemër	Zona kad.	Nr. pas.	Sipërf. e përgj. m ²	Sipërf. e prekur m ²	Çmimi për m ²	Vlefta në lekë	Konfirmimi i ZVRPP-së, Krujë
1	Seit Llubani	8621	6/266	214	25.5	4011	102,281	Konfirmimi i ZVRPP-së, Krujë
2	Bukurije Llubani	8621	6/267	117.5	15	4011	60,165	Konfirmimi i ZVRPP-së, Krujë
3	Shpend Llubani	8621	6/200	146	21.2	4011	85,033	Konfirmimi i ZVRPP-së, Krujë
						Total	247,479	